

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Antares Inc.” sh.p.k**

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR  
"Antares Inc." sh.p.k**

Sot në datën 21.01.2021 bazuar në ligjin Nr. 9901 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe ne ligjt Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, themeluesi:

**ELIOS RISTA**, i biri i Anestit, i datëlindjes 05.07.1995, me numër personal të kartës së identitetit J50705101F lindur në Fier e banues në Tiranë, me adresë Rruga "Xhorxhi Martini", Pallati "Kolombo 2", Ap. 16, Nj.A. 2, Tiranë me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të krijojë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, redaktoi dhe nënshkroi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Antares Inc." sh.p.k më poshtë vijon:

**Kreu I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**

**Emri, Data e Themelimit dhe Themeluesit**

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "Antares Inc." sh.p.k. (më poshtë e quajtur "Shoqëria") e cila është themeluar më datën 21.01.2021.

1.2 Shoqëria "Antares Inc." sh.p.k themelohet nga ortaku i vetëm:

- **ELIOS RISTA**, i biri i Anestit, i datëlindjes 05.07.1995, me numër personal të kartës së identitetit J50705101F lindur në Fier e banues në Tiranë, Rruga "Xhorxhi Martini", Pallati "Kolombo 2", Ap. 16, Nj.A. 2, Tiranë me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- Adresa Zyrtare e-mail i shoqërisë do të jetë adresa: [eliosrista01@gmail.com](mailto:eliosrista01@gmail.com)
- Numri i Kontaktit të Shoqërisë do të jetë: +355 69 466 5555

**Neni 2**

**Objekti**

- 2.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
1. Bar, restorant, piceri, catering, organizim eventesh;
  2. Tregti me shumicë e pakicë e artikujve të ndryshëm;
  3. Import - eksport i mallrave industriale, ushqimore;
  4. Transport mallrash;
  5. Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit;
  6. Veprimitari në fushën e përpunimit dhe përfundimit të materialeve me mall të porositësit;
  7. Punime artistike, qëndistari, rrobaqepësi, bizhuteri;
  8. Aktivitet në fushën e hoteleri turizmit;
  9. Prodhim energjie dhe tregtimin e saj;

10. Konsulenca dhe këshillime

11. Ndërtimë civile, industriale, bujqësore dhe turistike, projektim – ndërtim – zbatim të veprave ndërtimore, asfaltim rrugesh, punime mirembajtjeje, sinjalistike etj..

2.2 Për të realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjeter të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar dhe mund te shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

**Neni 4  
Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Dyqani 9, Kompleksi "Square 21", "Ruga e Kavajës", Nj.A. 7 , Bashkia Tiranë.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Kreu II**

**KAPITALI**

**Neni 5  
Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themelues i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, e shprehur në 1 kuotë, të kontribuara nga ortaku në vlerën monetare 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku i vetëm që zotëron 100 % (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht nga:

Z. **ELIOS RISTA**, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, i datëlindjes 05.07.1995, me numër personal të kartës së identitetit J50705101F lindur në Fier e banues në Tirane, me adresë Rruga "Xhorxhi Martini", Pallati "Kolombo 2", Ap. 16, Nj.A. 2, Tiranë i cili zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar

për kontributet në para dhe me anë te kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENNDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve ështe organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse përmarrjen e vendimeve përshoqërinë për çëshjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- i) pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

##### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar përr mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk eshtë thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

##### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nësë marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çëshje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

##### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecucisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave proçedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 12  
Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në te njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 13  
Administrimi**

- a) Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje: Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- b) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- c) Personi e mëposhtëm caktohet si Administrator: Z. Elios Rista i cili do të ushtrojë kompetencat për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

**Neni 14  
Kompetencat e Administratorit/ëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit, të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhë të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dher nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veptimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratorët janë te detyruar të thërrasin Asamblenë e Pergjithshme, në rastet kur:

- i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detytimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetevë të shoqërisë; që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkëtisht shoqerinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bázë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

### **Neni 15 Përgjegjësitet e Administratorit/ëve**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera, gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas, neneve 14, 15, 17 e 18 të 1igjit "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare", administratori detyrohet:

1.

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçatitë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktura në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare,
  4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
    - a) u kthen ortakëve kontributet;
    - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
    - c) u shpërdan aktivet shoqërisë
    - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, ne bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
    - e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse ëshi ë është nevojshme. Asnjë vendim i. asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë- padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Neni 16

#### Vula

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

### Kreu IV VITI FINANCIAR DHE EKSPERTËT

**Neni 17  
Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillori nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

**Neni 18  
Kontrolli Financiar**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjisacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar ne ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

**Neni 19  
Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**Neni 20  
Bilanci vjetor**

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

**Neni 21  
Dividenti**

Pasi të jenë përbushur kërkesa e përcaktuara nga Ligji "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", Shoqëria, mund të vendosë shpërndarjen e dividendi të përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

**Kreu V  
PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 22  
Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;
- e) më vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 23  
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 24  
Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 25  
Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 26**

Zbatimi i kuadrit ligjor

Shoëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut si dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë dokument, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë u përpilua në katër kopje, për t'jua shpërndarë organeve kopetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "Antares Inc." sh.p.k..

**ORTAKU I VETËM**

**ELIOS RISTA**

Elios Rista